



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë si dhe nenit 20 par. 20.1, 33 dhe 34 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kërkon nga Kuvendi i Komunës që në mbledhjen e datës _____ të miratojë këtë:

PROPOZIM

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Kryesuesi i Kuvendit është Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 3

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mandat 4 vjeçar

Neni 4

Për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa emërohen si vijon:

1. _____, Kryesuesi i Kuvendit
2. _____, anëtar i kuvendit nga LDK
3. _____, anëtare e kuvendit nga LDK
4. _____, anëtare e kuvendit nga LDK
5. _____, anëtar i kuvendit nga PDK
6. _____, anëtare e kuvendit nga PDK
7. _____, anëtar/e e kuvendit nga LVV

Neni 5

Komiteti për politikë dhe financa në pajtim me dispozitat e nenit 52 par.52.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e e neneve 12, 51 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë si dhe nenit 20 par. 20.1 , 33 dhe 34 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

15Nr. 020/08-67530
Lipjan, më 10.12.2025

KRYESUESI I KUVENDIT

Daut Azemi

